



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 10 prill 2014, në mbledhjen e IV-të (katërt) të Kuvendit.

Mbledhja filloi në orën 10:10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuromi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm drejtorët e Drejtive komunale, z. Muhammed Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pas dorëheqjes së parevokueshme të ish këshilltarit të Kuvendit nga radhët e subjektit politik LDK z. Agron Hyseni i emëruar tani drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është iniciuar kërkesa për zëvendësimin e tij dhe me vendimin nr. 520 – 2014 të datës 21 mars 2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vend të këshilltari të cekur është emëruar z. Hasan Softollit këshilltar nga radhët e subjektit të njëjtë politik, andaj në kontekst të kësaj ftoj Komisionin për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës të bënë verifikimin.

z. Afrim Shabani, në emër të komisionit, theksoi, në bazë të vendimit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve nr. 520 – 2014 të datës 21 mars 2014 z. Hasan Softollit nga subjekti politik LDK emërohet këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës duke zëvendësuar z. Agron Hysenin.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fton z. Hasan Softollin të bënë Betimin solemn, dhe pasi lexojnë bashkërisht deklaratën e betimit, Kryesuesi i uron mandatin.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur dy ditë më parë janë propozuar edhe dy pikat për rend dite, ashtu siç i keni në konstatime, ato janë:

- Themelimi i Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane të qytetit, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, i cili i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, dhe

- Çështja e lokacionit për ndërtimin e Obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, për të cilën kemi vendosur që të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa më 15.04.2014

- z. Kadri Avdiu**, theksoi, është e vërtetë ajo që e tha Kryesuesi i Kuvendit rreth rekomandimeve të KPF-së të mbajtur më 08.04.2014, mirëpo sa i përket çështjes së Obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, është një vendim e jo vetëm një rekomandim siç e tha Kryesuesi, pra është caktuar data 15.04.2014 në orën 13:00 të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e KPF-së vetëm me këtë çështje, dhe që Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë të sjell në atë mbledhje të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me Obeliskun, e pastaj të procedohet në Kuvend.
- z. Avni Ajeti**, theksoi, është e mirë ajo që e potencoi parafolësi po ashtu dhe diskutimet e mëparshme të këshilltarëve rreth kësaj çështjeje, mirëpo mua më bënë përshtypje ndarja e Heronje Afrim Zhitia e Fahri Fazliu, gjë për të cilën pyes se pse është kjo ndarje dhe pse nuk diskutohet edhe për një Obelisk të Heroit Fahri Fazliu.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës duke u përfshirë edhe pikat;

- ❖ **Themelimi i Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane të qytetit, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, i cili i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim**

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 21 shkurt 2014 (e ndërprerë) dhe vazhdimi i mbledhjes më 13 mars 2014

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, në diskutimin tim të mbledhjes së kaluar, kamë vërejtur një fjalë në faqen 12 e cila është shkruar gabimisht por që është shumë përmbajtjesore, e që unë kamë thënë, "Meqë Grupi juaj (ka qenë fjala për grupin e LDK-së) nuk e respekton ligjin" , ndërsa në procesverbal është shkruar "Meqë Grupi jonë nuk respekton ligjin". Prandaj kërkoj që kjo të korrigohet.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua procesverbali me plotësim ndryshimin e paraqitur nga parafolësi

3. Raporti financiar për vitin 2014

- z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.
- z. Fidan Rekaliu**, theksoi, ne këshilltarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës duke shprehur vlerësimin dhe opinioni tonë lidhur me Raportin Financiar për vitin 2013 konsiderojmë se ky raport plotëson të gjitha kërkesat ligjore në të cilat parashihet që raporti përkatës të jetë përbledhës dhe t'i pasqyron të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën përkatëse, e që ky raport pasqyron mjaft mirë të ardhurat dhe shpenzimet që janë bërë në Komunën tonë gjatë vitit 2013.

Gjithashtu vlerësojmë se është një raport gjithëpërfshirës, real, i thjesht dhe i kuptueshëm si për profesionist po ashtu edhe për ata që nuk janë profesionist të kësaj natyre dhe

vlerësojmë se është një raport mjaft i mirë si në aspektin profesional dhe në atë teknik gjë për të cilën e përgëzojmë drejtorin dhe stafin e tij për punën e mirë.

Paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere si dhe investime kapitale, që të gjitha këtu janë paraqitur edhe në mënyrë grafike të shprehura edhe në përqindje. Nëse e analizojmë raportin te pasqyrat financiare sipas kodeve ekonomike ku kemi një krahasim të shpenzimeve të shprehura në përqindje duke krahasuar vitin 2012 me atë 2013 vërejmë se në shumë kode kemi zvogëlim të shpenzimeve, si për shembull; shpenzimet e telefonisë fikse kanë shënuar zvogëlim për 23%, furnizimet për zyre 63%, shpenzimet për ushqim dhe pije për 14%, karburante për vetura janë zvogëluar 40%, shpenzimet për dreka zyrtare janë zvogëluar rrëth 130%, e tjera, mirëpo që të jemi real ka edhe disa shpenzime nëpër disa kode ekonomike që kanë shënuar ngritje për të cilat do të dëshironim që edhe këto të ishin më të vogla, por duke mos cenuar funksionimin normal të punëve sepse në të kundërtën nuk do të kishte efekt ky zvogëlim. Në këtë raport përvëç shpenzimeve na paraqiten edhe zëra për të hyrat e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2013.

Krejt në fund mendoj se ky raport meriton të vlerësohet dhe të përkrahet pa pretenduar se nuk ka vend dhe për më mirë, çka mendojmë se gjithherë ka mundësi për mirë e më mirë sepse në realitet asgjë nuk ka të përsosur sado që ne pretendojmë për një gjë të tillë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me reportin finanziar për vitin 2013 ne mendojmë se në këtë raport ka lëshime, ka shpenzime të pa miratuara në Kuvend për të cilat mendojmë se janë bërë shkelje ligjore sepse çdo shpenzim që bëhet pa miratim të Kuvendit është shkelje ligjore.

Duke filluar prej faqes së parë të raportit, ku vetëm për rrymë në vitin 2013 janë shpenzuar 144,341.71 €, që i bie 13 % më shumë se në vitin 2012, ku sigurisht se ne të gjithë jemi në dijeni se në vitin 2013 çfarë dimri ka qenë, shpenzime telefonike mobile janë 16,744.22 € ku në vitin 2012 ishin 9,540.37 €, pastaj furnizim për zyre 114,334.09 € ku në krahasim me vitin 2012 ka një zvogëlim të shpenzimeve por që ende mendoj se është shumë e madhe e shpenzimeve, te kodi 13720 është naftë për ngrohje ku kemi të shpenzuara 67,202.47 €, do të thotë se edhe këtu kemi ngritje të shpenzimeve 23%, mirëpo çka është më e keqja dhe më e pakuptimta është se në kodin 13750, kemi shpenzime për qymyr 65,853.64 € e që i bie një ngritje prej 87% në raport me vitin 2012, gjithashtu edhe te shpenzimet për dru 81,185.46 € gjë për të cilën nuk mendoj se është në rregull, por më shqetësuese për mua është kodi 14010 ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve ku për vitin 2013 janë 35,354.68 € që do të thotë se nga këto mjete të shpenzuara kanë mundur të blihen automjete të reja dhe të mos shpenzohen fare mjete për servisim dhe mirëmbajtje të tyre, te shpenzimet gjyqësore, e që është evidente se mos kryerja e punëve me kohë, gjobitet Ekzekutivi i Komunës nga gjykata, te kodi 31900 kapital tjetër 533,258.16 € ku nuk dihet se për çfarë shpenzimesh bëhet fjalë. Prapë në një vend tjetër thuhet, kapita tjetër 36,374.45 € gjë që edhe për këtë nuk jam në dijeni se për çfarë shpenzimesh bëhet fjalë dhe pse përsëritet dy herë kapital tjetër, gjithashtu edhe Administrata përsëritet 3 – 4 herë me kode të ndryshme dhe shpenzime sipas programeve dhe kategorive ekonomike.

Prandaj për këto dhe çështje të tjera konsideroj se në këtë raport ka lëshime të mëdha dhe mund të ketë vend edhe për hetues, dhe konsideroj se kjo nuk i'u bënë mirë qytetarëve por vetëm individëve të caktuar.

Një gjë të cilën dëshiroj ta them konkretisht, mos të keqkuptohemi se nuk jemi kundër projekteve por jemi për t'i respektuar Ligjet dhe rregullat, në fshatin Bellopojë në vitin 2013 kemi të miratuara 30,000.oo €, në fshatin Tërrnavë 60,000.oo €, të miratuara dhe të ridestinuara nga Kuvendi, ndërsa në raport kemi 133,999.oo € e që diferenca është 43,999.oo €, e që kjo shumë të shpenzohet pa pëlqim të Kuvendit, për mendim tim është një shkelje ligjore

Kemi ndërtimin e rrugicave të cilat nuk janë të përfshira në këtë raport, dhe një urë e cila është ndërtuar dhe që nuk është përfshirë në këtë raport fare apo nuk jam në dijeni nëse është përfshirë në ndonjë kod, prandaj këtu kemi të bëjmë me çështje të cilat bien ndesh me atë që e thash më parë dhe e cila është shkelje ligjore e Ekzekutivit të Komunës në raport me Legjislativin e Komunës, dhe konsideroj se nëse vazhdohet të veprohet në këtë mënyrë atëherë çfarë kuptimi ka legjislativi që nuk pyetet fare. Kjo gjë ndoshta juve ju duket gjë e imët por këto kanë ndodhur në periudhën e fundit të vitiit dhe gjithmonë ajo bartja e mjeteve prej një viti në vitin tjetër dhe mbulesat me dokumente shumë mirë fshehën sepse është dhënë mundësia e bartjes çështje të cilën e kam potencuar edhe më parë dhe po e përsërisë prapë se Ekzekutivi i Komunës ka mjeshtëri sa që ia kalon edhe shërbimeve të CIA-së.

z. Haki Rudari, theksoi, ne kemi analizuar, shtjelluar dhe zërthyer këtë raport financiar dhe kemi ardhur në përfundim se ka shumë mangësi, zbrazëtira apo edhe shumë defekte ku në vazhdim do të përpinqem t'i them të gjitha.

Pasqyrat apo kodet e paraqitura nga Drejtoritë e Administratës Komunale shprehin shpenzime të paarsyeshme por edhe shpërndarje jo të mirë të projekteve në terren. Jemi të mendimit se menaxhimi më i mirë i këtyre projekteve nga ana e Drejtive do të kishte një rritje të transparencës por realisht do të kishte edhe ngritje të cilësisë së qytetarëve. Pra Grupi jonë i këshilltarëve e kritikon këtë raport, jo nga aspekti politikë sa për të thënë diçka, por nga mënyra e menaxhimit të ndarjes së mjeteve financiare dhe projekteve të ndryshme.

Mendoj se krahas raportit financiar duhet të kemi edhe një plan program të punës për të pasur një kohezion në mes veti. Një raport i përpiluar në bazë të shifrave por që ka shumë dobësi kur të analizohet në brendësi ku sidomos kemi një rritje të shpenzimeve në disa kode ekonomike të cilat i kamë nxjerr nga ky material, dhe nëse vijmë në një përfundim atëherë mund të vërehet një rritje e madhe nga viti 2012 në vitin 2013, kemi përsëritje të shifrave nga një tabelë në tabelën tjetër pa dhënë shpjegime të qarta se si janë shpenzuar mjetet buxhetore në terren.

Përkundër shpenzimit të buxhetit prej 98% që fillimisht të lënë përshtypje shumë të mirë, qytetarët e Komunës së Podujevës ende kanë probleme e ankesa dhe sidomos sot më duhet të ngris një çështje shumë të rëndësishme dhe serioze para juve, se gjatë fushatës së zgjedhjeve është premtuar shumë nga subjektet politike, njëkohësisht edhe nga subjekti i cili ka pushtetin në Komunën e Podujevës, çështje e cila ka të bëjë me ujin ndërsa askund nuk përmendet se ka shpenzime për ujin kur dihet se ky problem për qytetarët e Komunës së Podujevës është shumë serioz dhe i rëndësishëm. Tjetër gjë të cilën dëshiroj të ngris në formë të pyetjes është se sa është i kënaqur drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në realizimin e të hyrave vetanake ku për mendimin tim vërehet një inkasim jo i mirë, duke përashtuar tatimin në pronë ku kemi një rritje prej 125%.

Një çështje tjetër të cilën po ashtu dëshiroj të përmendi është se përkundër shumë investimeve të bëra të cilat ne si Lëvizje Vetëvendosje i përkrahim kudo që janë, por nuk i përkrahim investimet nga aspekti politikë apo kadrovik nga vijnë, e në këtë kontekst po e përmendi vetëm një rast, në fshatin Shajkoc është investuar mjaft në rrugë por shumë herë është premtuar trotuari që është çështje shumë e ndjeshme dhe që nuk është realizuar, kur dihet se nxënësit vazhdimisht udhëtojnë dhe u paraqitet rrezik në rrugëtimin e tyre. Gjithashtu kemi nxjerrë edhe disa shifra dhe përgjindje për të cilat kemi vërejtje, si; Shfrytëzimi i telefonisë mobile 9,540.37 € në vitin 2012, ndërsa në vitin 2013 janë rritur 16,744.22 € që i bie 75.51% rritje të shpenzimeve, shërbime të kontraktuara tjera me një rritje të investimeve por jo ndoshta me këtë përqindje, në vitin 2012 nuk ka pasur fare shpenzime pastaj naftë për ngrohje qendrore kemi 23% rritje në krahasim me vitin 2012, po ashtu shpenzimet për qymyr kanë rritje prej 87.34%, rritje të madhe të shpenzimeve kemi edhe për servisim të automjeteve zyrtare ku në vitin 2012 kemi pasur 7,545 € ndërsa në vitin 2013 kemi 14,533.88€ shprehur në përqindje 92.62% rritje.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, do të përpinqem të mos i përsërisë të gjitha ato që u thanë nga parafolësit, por nuk pajtohem me përfaqësuesin e LDK-së i cili në diskutimin e tij e potencoi se kemi zgogjrim të shpenzimeve për 130%, sepse i bie se nuk është harxhuar fare por janë deponuar mjete sepse 100% i bie zero.

Së pari raporti finanziar në formën e prezantuar është gogja i zorshme të zbërthehet nga Kuvendi Komunal duke marrë parasysh që asambleistët janë të profesioneve të ndryshme. Ky raport në këtë formë nuk ka fare qartësi dhe dalin shumë dilema dhe dyshime për menaxhim të papërgjegjshëm të parasë publike. Fitohet përshtypja se Komuna trajtohet si qendër e LDK-së e jo si qendër administrative e të gjithë qytetarëve të Podujevës. Shpenzimi i buxhetit lë përshtypjen se është bërë në masë të madhe për fitimin e zgjedhjeve të vjetme lokale e jo për zhvillimin socialo-ekonomik të Komunës.

Ka shumë shembuj që i ngrisin këto dilema por unë do të provoj që ti përmend vetëm disa prej tyre që konsideroj që flasin në favor të asaj që e thash më parë.

E para, ndarja me dhjetëra projekte kompanive të caktuara (bie fjala Milenium Konstruksion me 721,259.70 € apo Toifor me 731,692.42 € që bëjnë rreth 25% të buxhetit për investime kapitale) përforcon dyshimet për klientizëm aq shumë të përfolur. Apo si ka mundësi që Bini-t ti ndahen vitin e kaluar 50% (rreth 105,000.00 €) e kostos së projektit të Llapashticës së Epërme për kanalizimin fekal në momentin e fillimit të punimeve, apo Vellezërve Hyseni tu keni paguar rreth 200,000.00 € në emër të promovimit të zhvillimit, unë jam në dijeni se kjo kompani kryen punë të ndërtimtarisë së ulët apo më së shumti shtrimin e trotuareve, por që merret edhe me promovim zhvillimi këtë gjë e mësova nga ky raport.

E dyta, keni investuar gogja shumë në projekte të ndryshme në Liqenin e Batllavës në hapësirat që nuk janë pronë e Komunës, këtu janë harxhuar shumë para dhe ekziston rreziku se duhet t'i rrënoni këto investime për shkak të ankimit të Misinstrisë së Mjedisit, ju keni thënë se ato janë investime të BE, por këtu na dalin të Komunës, dikund vetëm për toboganë janë paguar rreth 9.000 € e pastaj sa projekte tjera.

E treta, ndarja e subvencioneve dhe mbështetje e etnive jopublike lënë shumë për të dyshuar, bie fjala SHGLL-së i keni ndarë 2,700 € e ajo sa unë kam njojuri është inekzistente, këtu ka edhe gazeta dhe nëse e kam gabim i lus të më korrigojnë.

E katërtë, shpenzime gogja shumë i keni të pakontrolluara, apo si ka mundësi që të keni paguar shpenzime të telefonisë fikse për GLV Llapi e cila në fakt nuk funksionon e as nuk

ka zyre e as telefon ose për petty cash, që këtyre herë i thoshin gjeparac, i keni prezantuar shpenzime 39,000.00 €, apo si ka mundësi që në Visari DPZ të keni blerë vaj për ngrohje në vlerë prej 131.20 € apo në autoservisin Color DPZ të keni blerë po ashtu karburante për vetura 165.13 € dhe derivate për gjenerator 94.85 €, apo në librarinë Fusha NTP ku jeni furnizue me materiale hargjuese për zyra, të keni blerë edhe derivate për gjenerator 850.29 €, as Visari DPZ, as autoservis Color e as Fusha nuk janë të licencuara të shesin derivate.

E pesta, Fotonikon-it i keni paguar 10,197.74 €, kjo gogja po i bje që kaq u kanë kushtuar materialet zgjedhore në zgjedhjet e kaluara, apo Mozart DPT 3,165.00 € për teknikë zërimi që sikur po i bie që krejt zërimin e fushatës e keni paguar prej buxhetit komunal, nuk ma merr mendja që keni pasur atë shumë aktivitete as në kulturë e as në ndonjë lëmi tjetër që tju duhej të paguani kaq shumë zërim (që po bie rrëth 30 tubime me i mbulu).

I keni paguar 6,000.00 € The European Times për një publikim prej 3 faqeve, nuk jam në dijeni se a e ka parë ndonjëherë ndokush prej kolegëve këtë publikim, po edhe të jetë publikuar është çmim i lart mbaze me kaq shumë para edhe në gazeta prestigjioze botërore keni mundur ta bëni këtë gjë e që do të kishte më shumë efekt, përfat të keq s'jeni e vëtmja Komunë në Kosovë që e keni bërë këtë. Keni prezantuar gogja një shumë të parave të shpenzuara (8,600.00 €) për vendosjen e skulpturave, rregullimin dhe mirëmbajtjen e busteve , e siç e dini të gjithë, sa për buste dhe përmendore Komuna janë është rahat.

E gjashta, në vitin e kaluar elektoral keni pasur mbi 40 persona të punësuar me kontratë mbi vepër, 14 persona i keni pas tërë vitin kalendarik ose 12 muaj, me siguri se disa prej tyre akoma janë duke e vazhduar punën në të njëjtën mënyrë, janë aktivist tuaj, familjar tuaj, gra të funksionarëve kyç të LDK-së brenda Komunës, përfillet se ka njeri që me vite të tëra punon pérherë me kontratë mbi vepër.

E shtata, në disa raste ose jeni vonuar për ti kryer obligimet ose unë nuk jam në dijeni pse disa pagesa i keni realizuar me LMFB-në dhe me vendime gjyqësore, ka edhe koleg tanë këtu në këtë sallë që ka qenë i detyruar ti inkasoj me vendim gjyqësorë obligimet e Komunës që ka pas ndaj tij apo të mos flas për Infrakos, Bendoni dhe gogja raste tjera por nuk mund të kaloj një që bie në shpenzime të reprezentacionit ku ju më pak se gjysmën e tyre i keni rexhistruar si dreka dhe darka zyrtare ndërsa shumicën dreka dhe darka dhe pije (fjala është për restaurante) që po i bie se këto mjete i keni harxhuar me aktivistët tuaj në fushatën zgjedhore, dhe çka është e veçanta këtu DPH llirët ju kanë inkasuar borxhe prej 494.00 € me forcën e ligjit, pra me vendim gjyqësorë, kjo vërtet nuk ka kuptim ngase kur të hani dhe të pini është mirë të paguani e mos i dëmtoni hotelierët tanë.

Zonja dhe zotërinj, vetëm sipërfaqësisht nga përshkrimet që ju i keni bërë, pa hyrë në analizën e këtyre gjërave por vetëm disa vërejtje të cilat i vërejta për pak kohë, dhe konsideroj se ka shumë çka në këtë raport për tu analizuar nga ekspertët e fushës së financave publike dhe nga institucionet e vendit sepse ky raport lënë shumë dyshime për menaxhim të papërgjegjshëm të parasë së taksapaguesve tanë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, për disa pika ndoshta nuk ja vlen ti potencojmë prapë ngase i thanë parafolësit tanë, por ne dëgjuam kolegut Fidan Rekaliun i cili e cilësoj këtë raport pozitiv, mirëpo unë këtë raport e kam krahasuar me atë të vitit 2012 dhe kam arritur të evidentoj që në shpenzime komunale, shpenzimet për personat publikë apo zyrtar të Komunës janë ngritur rrëth 87% , shembull ta marrim telefonin mobile ku në vitin

2012 kanë qenë të shpenzuara 9,540.37 € kurse në vitin 2013 kanë arritur 16,744.22 €, pikë të cilën e cekën edhe parafolësit tanë, mirëpo ne të gjithë jemi në dijeni se zyrtarët administrativ dhe gjithë struktura menaxhuese punon në zyra, andaj për të gjitha këto shpenzime të telefonisë mobile konsideroj se janë bërë për çështje private gjë e cila do të mund të identifikohej me ndonjë transkript telefonik, çështje tjetër është, shpenzimet për paga dhe mëditje për të cilat mendoj se Ekzekutivi i Komunës, në bazë të ligjit të shërbimit civil të Kosovës e që e arsyetoj një shumë prej 9,000,000.oo € drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, mirëpo ky ligj nuk e lejon që asnjë punëtorë të mbahet me kontratë mbi vepër për as edhe një ditë, kurse në Komunën tonë kemi punëtorë, kryesish në Shëndetësi dhe Arsim me kontratë mbi vepër në një afat të stërvizgjatur, gjithashtu kemi punëtorë të cilët punojnë me diploma të pa nostrifikuar për të cilët në një mbledhje të ardhshme sigurisht se do ti potencojoj këto çështje në Kuvend, në Ekzekutiv por edhe në organet e rendit, ata të cilët e kanë dëmtuar buxhetin e Komunës. Vërejtje në këtë raport kamë edhe te shpenzimet për vendime gjyqësore për të cilat Komuna është dashur të paguaj extra për arsyet e shkeljeve që i ka bërë, po ashtu në Parkun Batllava, shpenzimet që janë bërë në atë pjesë është dëmtuar mirëqenia sociale e qytetarëve për arsyet se ka qenë shumë e madhe e mjeteve e ndarë nga Komisioni European të cilën qytetarët kanë mundur ta gëzojnë ndërsa Komuna jonë ka menduar të qëndroj një plazh në Liqenin e Batllavës ku për një tobogan ka paguar mbi 7,000.oo €, ndërsa ne jemi në dijeni se si është shfrytëzuar sezoni verorë në Liqenin e Batllavës dhe si është degraduar aj Liqen, kurse në anën tjetër qytetarët tanë nuk kanë ujë të pjesë sepse nuk funksionon mbi 70% e rrjetit të ujit, gjithashtu kemi shpenzime rreth 45,000.oo € për pajisje speciale mjekësore për të cilat besoj se as vetë këshilltarët e cilit do subjekt këtu nuk janë në dijeni se çfarë pajisjesh bëhet fjalë dhe çfarë shërbimesh medicinale kryhen në Komunën tonë dhe si është gjendja e shëndetësisë, duke përashtuar kontributin e çdo shërbyesi shëndetësorë në territorin e Komunës tonë, shërbyes apo staf të cilët bëjnë përpjekje për shërbime sa më të mira shëndetësore por që i'u mungojnë pajisje për të cilat jemi në dijeni ne të gjithë.

Nga Komuna jonë janë kryer pagesa për një kompani qe 13 vite me radhë, është dhënë faza tenderuese për një kompani e cila operon edhe në një Komunë tjetër me tender njëburimorë dhe që janë kryer ato pagesa, ndërsa sot në këtë Kuvend mundohet të arsyetohet ky raport financier gjë e cila është shumë e drejtë nga ana e përpiluesve të raportit që të mundohet ti arsyetoj shpenzimet e bëra, mirëpo mendoj se shkeljet janë evidente dhe se sigurisht se edhe ata vetë janë në dijeni për këtë.

Në raport cekën 49,795.oo € për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, ndërsa sinqerisht po e them se këtë mirëmbajtje mund ta kuptojmë, rregullim, mirëmbajtje dimërore e tjera, dhe pyes se si është bërë kjo mirëmbajtje dhe a ka pasur fazë tenderuese për mirëmbajtje dimërore të rrugëve në Komunën tonë, nëse po atëherë drejtori i Drejtorisë përkatëse le të na sqarojë këtë, ne përafërsisht jemi në dijeni se sa ka qenë faza tenderuese për mirëmbajtje dimërore të rrugëve dhe sa kanë qenë limitet e shpenzimeve kur dihet se nuk ka pasur reshje të borës.

z. Kumrie Hoti, theksoi, kryesish jam fokusuar në investimet kapitale ashtu sikurse e kam potencuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku pas një analize të thellë të raportit financier për vitin 2013 më duhet të potencojoj se për mendimin tim ka pasur shumë shkelje në përcaktimin dhe implementimin respektivisht realizimin e projekteve të shumta në Komunën tonë gjatë vitit 2013. Kur e them këtë kam parasysh edhe kornizën

afatmesme buxhetore të Komunës së Podujevës për vitet 2012-2014 dhe atë për vitet 2014-2016. Në këtë kontekst dhe duke krahasuar projektet prioritare në këto dy korniza dhe duke analizuar raportin financiar për vitin 2013 më duhet të them dhe jam e mendimit se ka pasur një ndarje jo reale të buxhetit në disa pjesë të Komunës së Podujevës e posaçërisht në fshatin Revuç, fshat i cili ka rrëth 105 familje me gjithsejtë 1200 banorë dhe më shumë se gjysma nuk i kanë të asfaltuara rrugët kryesore të tyre që i bie 56% ose rrëth 650 banorë, ndërsa rrugët e asfaltuara janë rrëth 4100 metra dhe po e përsërisë se janë vetëm rrugët kryesore që në pjesë të caktuara nuk ka fare banorë. Unë këtu kam edhe një hartë të fshatit Revuç në formë të ortofotove të cilën jua prezantoj dhe juve ku mund të shikoni e që rrugët e asfaltuara paraqiten në fotografi me ngjyrë të gjelbër derisa ato të pa asfaltuara janë me ngjyrë të kuqe, prej këtyre me ngjyrë të gjelbër në njérën anë kemi rrëth 670 metra rrugë që kalon nëpër fusha dhe që i lidhën vetëm 8 familje dhe tjetra i ka 525 metra prapë nëpër fusha dhe që i lidhë 13 familje ku të dyja bashkëlidhin vetëm 110 banorë. Të pa asfaltuara janë edhe rrëth 4300 metra rrugë kryesore gjithnjë duke mos i përfshirë rrugët lidhëse apo rrugicat e fshatit. Pastaj kemi rastin e fshati Dobratin me rrëth 95% i asfaltuar duke përfshirë edhe rrugicat, po ashtu fshatrat Metehi, Dobërdol, Bradash, Bajqinë, madje edhe fshati Kërpimeh, por gjendjen pothuajse sikurse fshati Revuç e ka edhe fshati Pakashticë.

Duke marrë për bazë dokumentet e përmendura më lart e them se anëtarët e Kuvendit nuk ju kanë mbajtur betimit të dhënë gjë e cila nuk është në rregull, pastaj neni 2 paragrafi 2.2 i Statutit të Komunës së Podujevës, thotë; *Organet e Komunës kujdesen që qytetarët t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim të gëzojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta në shërbimet komunale*, tanë pyetja ime është, si ka pasur mundësi që rruga kryesore e fshatit Revuç respektivisht vazhdimi i kësaj rruge e cila në kornizën afatmesme buxhetore 2012-2014 ishte projekti prioritar për vitin 2012 dhe atë nga granti prej 95,000.oo € dhe nuk ka ndodhur kurrë, pra ku është dallimi i këtyre qytetarëve nga të tjerët, projekt i njëjtë si projekt prioritar për investim prej 50,000.oo € nga granti ishte prioritet edhe për vitin 2013, dhe nuk është realizuar, po ashtu projekt i njëjtë me një planifikim për investim prej 90,000.oo € nga granti është prioritet edhe për vitin 2014, pra gjithmonë jemi duke folur për rrëth 150,000.oo € investime në një rrugë e cila u bënë zgjidhje 600 banorëve e që nuk është bërë kurrë, por do të shohim se a do të jemi ne ata që do të angazhohemi që edhe këtyre qytetarëve t'ju ofrojmë të drejtën e tyre elementare e në të njëjtën kohë edhe ta përbushim obligimin tonë kushtetues e ligjor.

Në raportin financiar për vitin 2013 pasqyra e pagesave të kryera për operatorët ekonomik që kanë kryer punime tregon se vetëm gjatë vitit 2013 mes shumë projekteve të tjera në Komunën tonë, shembull në fshatin Bradash vetëm për asfaltim janë paguar shërbime në vlerë totale 217,490.oo €, në fshatin Sfeqël gjatë vitit 2013 janë asfaltuar rrugët sekondare në vlerë 152,282.oo €, ndërsa në fshati Revuç janë investuar rrëth 15,000.oo € për një rrugë rrëth 400 metra e cila lidhë 18 familje dhe e cila është asfaltuar gjatë kohës së zgjedhjeve lokale, tanë shtrohet pyetja se sa km. rrugë i ka fshati Bradash që duhet investuar 217,490.oo €, për asfaltim, kur dihet se është pothuajse fshati i parë që është asfaltuar në Komunën e Podujevës, dhe si ka mundësi që të jenë paguar 152,282.oo €, për rrugë sekondare përderisa banorët e Revuçit nuk e kanë të rregulluar as rrugën kryesore. Mendoj se kjo është mosrealizim i projekteve prioritare dhe një ndarje

joreale dhe jo e drejtë e buxhetit ndaj nevojave prioritare për qytetarët sepse atyre nuk iu janë ofruar shërbimet elementare për një jetë normale, ndërsa ne të gjithë jemi në dijeni se këto shërbime duhet t'iu ofrohen të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, deri më tanë ne nga diskutimet e bëra për raportin e financiar për vitin 2013 dëgjuam dy versione të ndryshme ku pozita në njérën anë këtë raport e cilëson si të mirë dhe me ulje të shpenzimeve në krahasim me vitin 2012 ndërsa në anën tjetër opozita thotë se ka pasur ngritje të shpenzimeve, kështu që unë kam një kërkësë për të cilën konsideroj se është shumë modeste, mbasë ka pasur ulje të shpenzimeve kërkoj që ato të hyra t'i orientojmë në fshati Llapashnicë të Poshtme përkatësisht për ndërtimin e shkollës e cila është vjetruar shumë dhe është jashtëzakonisht në gjendje të mjerueshme dhe e cila daton që nga viti 1945, pra kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit të merr në konsideratë këtë kërkësë sepse do të ishte një veprim i mirë dhe i duhur. Ndërsa e tërë opozita deri më tanë e potencuan se ka pasur ngritje të shpenzimeve, e unë në këtë kontekst bëjë thirrje që këto shpenzime të ulen.

z. Hasan Softolli, theksoi, lidhur me raportin financiar për vitin 2013 konsideroj se është raport plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e Kosovës po ashtu edhe me menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, si dhe është i përmbledhur dhe i dizajnuar në atë mënyrë që e bënë një dokument pozitiv, ndërsa faturat e pagesave dhe informatat tjera shtesë për shpenzime mundet secili këshilltarë i Kuvendit dhe qytetarë i Komunës së Podujevës t'i kërkojnë në Drejtoren përkatëse. Përndryshe të gjitha këto kategori të shpenzimeve janë shumë mirë të detajizuara dhe me përshkrim të mjaftueshme saqë po të krahasohet ky raport me raportet të Komunave tjera do të bindemi se është shumë më profesional. E them këtë ngase disa nga parafolësit e cekën që ky raport përmban elemente të shpenzimeve të mjeteve buxhetore në kohë të fushatës apo diçka të ngjashme, andaj unë nuk shohë kurfarë elementi, dhe asnjë pozicion nuk i jep ato informata se gjoja janë bërë ato shpenzime. Gjithashtu meqë u përmend nga një parafolës se shpenzimet janë bërë në kohë fushatë zgjedhore, ndërkaq unë i them se mu partia e tij është ajo e cila është e prirë për shpenzime të buxhetit për fushatë zgjedhore. Pra konsideroj se shpenzimet dhe buxheti janë harmonizuar në mënyrën më të mirë, kemi disa ngritje të shpenzimeve në pozicione të caktuara por kemi edhe pozicione me ulje të shpenzimeve. Por edhe një gjë është se për të gjitha këto që u thanë është edhe zyra e auditorit gjeneral e cila bënë auditimin e shpenzimeve të buxhetit dhe jep rekomandime dhe vërejtje në qoftë se gjen diçka.

z. Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që u tha këtu deri më tanë për raportin financiar për vitin 2013 më doli në pah një çështje mjaft shqetësuese, në rend të parë i uroj mandatin këshilltarit që po sa e dha betimin dhe e falënderoj që si këshilltarë i ri filloj të na shpjegoi dhe të na njoftoj se si bëhen raportet dhe si krahasohen me Komuna tjera, andaj të drejtohem ty zotëri këshilltarë i ri, këshilltari i Kuvendit të Komunës është përgjegjës për atë Komunë ku është zgjedhur dhe mua aspak nuk më bëjnë përshtypje se si e shpenzojnë buxhetin Komunat tjera sepse ne jemi këtu për të parë se si shpenzohet buxheti në Komunën tonë dhe nëse dëshironi të bëni ndonjë krahasim bëjeni, por ajo çështje vlen për ndonjë institut që merret me atë çështje ose për MAPL-në, por jo për këshilltarë të këtij Kuvendi.

U vu në aksent këtu, gjë të cilën e kam potencuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, nga gjithë ajo që pamë, për mua është shqetësuese se një pjesë e mirë e buxhetit të Komunës gjegjësisht e tak sapaguesve të Kosovës është harxhuar në kontrata

mbi vepër për një periudhë të gjatë kohore, po ashtu është shqetësuese që kemi disa pagesa të shoqatave të cilat për ne janë inekzistente gjë e cila duhet lënë të gjurmohet pse është ashtu, dhe në një formë jemi pajtuar në Komitet për Politikë e Financa se me këtë çështje që në një mbledhje të ardhshme të Kuvendit të diskutohet, të merren personat përgjegjës për të kontrolluar dhe se dihet se ku mund të deponohen, mirëpo nuk është e tepërt të thuhet këtu në këtë Kuvend sepse ky është vendi ku jemi duke debatuar se si është shpenzuar buxheti. Sa i përket fjalëve miradije se ky dokument është përgatitur shumë mirë nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave gjegjësisht zyrtari kryesor financier, unë nuk kamë shumë çfarë të shoj mirëpo ka mundur që ky raport të jetë më transparent për njerëz të cilët merren më pak me ekonomi gjë të cilën e kam ngritur shumë herë më përpara se është shumë e pakuptueshme nëse mblidhen shifrat dhe që na del 3,330,000,00 € investime në rrugë lokale dhe tani nga kjo çfarë kuptojmë ne, ndokush mund të thotë se ato rrugë janë rregulluar në Komunën tonë gjë e cila është e vërtetë, por ne kemi hartuar projekte prioritare për vitin 2013 dhe për këtë nuk ka si mos të lindë pyetja, pse nuk realizohen projektet të cilat janë miratuar në Kuvendin Komunal për vitin 2013, kurse investohen projekte tjera në shumë lokalitete ku asfaltohen rrugë pa projekte teknike dhe pyes a është në rregull kjo, përsë shtrohet në asfalt një lagje, nuk dëshiroj të përmendi votat por pyes se cili është hatri që shtrohen ato lagje, miqësia, dosllakia, ndikimi apo çka, ndërsa arsyeshmërinë nga ky Kuvend nuk e ka marr projekti përkates për tu realizuar në atë pjesë.

E përmendi parafolësi auditorin e jashtëm, për të cilin ne jemi në dijeni se nuk është në kompetencën tonë mirëpo jemi në dijeni se Ligji për financat publike dhe përgjegjësitë e përcakton se auditori i brendshëm është i obliguar t'i jap llogari këtij Kuvendi dhe Komitetit për Politikë dhe Financa e që është viti i tetë me radhë që nuk kemi pasur një raport nga auditori i brendshëm, andaj konsideroj se nuk mund t'i thuhet këtij raporti financier se është në rregull sepse është dashur t'i paraprij paraprakisht raporti financier nga auditori i brendshëm i Komunës.

Me të vërtetë nga ky raport kanë dalur në pah shumë shpenzime të cilat krijojnë shumë dilema dhe janë shpenzime shqetësuese të bëra nga Ekzekutivi i Komunës e njëra nga këto digastere është edhe Drejtoria të cilën e ka udhëhequr Kryesuesi aktual i Kuvendit.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, do të mundohem t'i jap disa sqarime dhe përgjigje rreth disa dilemave të cilat u ngriten deri më tani, dhe po filloj nga e para që është kodi kapital tjetër, në raportin përbledhës ashtu jam i obliguar të paraqesë për shkak se ky është plani kontabël të cilin e miraton Ministria e Financave për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, subvencione, dhe invesime kapitale, në investime kapitale janë rreth 20 – 30 kode ku nëse një shpenzim bëhet jashtë atyre mundësive është lënë kjo mundësi, në kapital tjetër e kam përmend edhe më parë se një gjë e cila nuk përfshihet këtu, shembull, nëse rregullojmë Lumin Llap nuk ka kod që përfshihet rregullimi i lumenjve prandaj patjetër duhet të ceket kapital tjetër, përndryshe çdo investim që nuk është përcaktuar në kod patjetër duhet të futet në kapital tjetër, mirëpo nëse ndalemi dhe shikojmë dosjen e atij investimi do të shohim se çka është punuar, pra me një fjalë, të gjitha ato shpenzime të cilat nuk figurojnë këtu me emër të veçantë janë të përbledhura në kapital tjetër.

Sa i përket asaj se pse tri herë përmendet Administratë, kemi të bëjmë me, Administratë Komunale kodi 16305 i cili i përmend edhe të gjitha Drejtoritë tjera në kuadër të Administratës Komunale siç janë Administrata e Arsimit e cila në përshkrim është vetëm

Administrata por që kodin e ka 92025, ndërsa tjetra është Administrata e Shëndetësisë me kod 73014, prandaj kjo është ajo se pse në raport tri herë përshkruhet termi Administratë.

Sa i përket çështjes e cila u ngrit këtu se pse kompania Vëllezërit Hyseni bënë promovim dhe zhvillim të turizmit, projekti në Ligenin e Batllavës është quajtur promovimi dhe zhvillimi i turizmit në Ligenin e Batllavës, projekt në të cilin ka pasur edhe punë ndërtimore n'kuadër të të cilit me tender publik e ka fituar kompania e cekur, prandaj edhe pagesa bëhet sipas projektit të cekur e që punëkryes ka qenë ajo kompani, e njëjta gjë qëndron edhe te marketingu që e ka bërë Foto Nikon në këtë projekt e që një pjesë e buxhetit është ndarë për marketing gjegjësish për ruajtjen e ambientit ku janë përfshirë fletushka, tabela e tjera, pra është mendur kryesisht për vetëdisimin e qytetarëve për ruajtjen e ambientit, e që Foto Nikon ka marr punë.

Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila është mbajtur dy ditë më parë, është ngritur edhe çështja e pagesave për derivate të naftës autoservisit Color gjë për të cilën t'ju them të drejtën edhe për mua ka qenë befasi ajo, por sot në mëngjes po sa kam ardhur në punë kamë filluar të hulumtoj se si ka ardhur deri te kjo ku në raport thuhet se i është bërë pagesë për naftë autoservisit Color, por që në rreth 1000 lëndë mundet të përvjedhët ndonjë gabim, andaj për këtë çështje ju siguroj që as edhe për 1 litër karburant nuk është paguar operatori i cekur por të gjitha këto mjete kanë shkuar në kompaninë të cilën e kemi kontraktuar, përshkrimi është karburant për vetura për ata edhe ka dal në raport ashtu, mirëpo është me rëndësi që kodi ekonomik për mirëmbajtje të automjeteve është 14010 kod i cili i dedikohet mirëmbajtjes së veturave, këtë lëndë mund të fotokopojmë dhe t'ua shpërndajmë të gjithë juve qka jeni këtu, po nëse dëshironi, në mënyrë që të heqim dilemat rreth kësaj çështjeje, lëndë e cila është kompletuar dhe në të cilën ndër të tjera ceket ajo qka është më me rëndësi që pagesa i është bërë atij që është dashur ti paguhet, pra në raport kemi vetëm një gabim teknik i cili është bërë në përshkrim. Sa i përket mirëmbajtjes dimërore të rrugëve për vitin 2013 që është 49,000.oo € është bërë në bazë të mbikëqyrjes dhe është paguar, e njëjta gjë është edhe te rrugët lokale që do të thotë se neve na e dikton plani kontabël në të cilin përfshihen të gjitha rrugët të cilat janë në kompetencë të Komunës, që janë ndërtuar brenda një viti e të cilat duhet të grumbullohen në total te kodi ekonomik rrugë lokale, po ashtu gjendje e njëjtë qëndron edhe në rastin e ndërtimit të kanalizimeve, andaj nëse në të ardhmen zgjerohet ky plan kontabël dhe na e mundëson të japim detaje më të mëdha në përshkrim, sigurisht se do të bëjmë atë.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, i nderuar drejtës i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, unë në fillim të diskutimit tim e thash se nuk dëshiroj të analizoj dhe kontestoj asgjë, mirëpo unë e lexova vetëm atë që ju e keni përshkruar në raport gjë të cilën dhe ju provuat të sqaroni, por autoservis Color, DPZ Visar, mirëmbajtje, servisim dhe karburant për vetura 165,13 € dhe derivate për gjenerator 94.85 €, gjithashtu libraria Fusha shkruhet dy herë furnizime, akomodime për mysafir, shërbime tjera kontraktuese rreth 2,600,oo € dhe derivate për gjenerator 850.26 € të përshkruara në raport, Visari DPZ mirëmbajtje, servisim dhe larje të automjeteve 482.50 €, por përfshihet edhe naft për ngrohje 131.20 € gjë të cilat i kamë parë edhe faturat për këtë pagesë sepse neve këshilltarëve na e ka hapur nga një adresë zyrtare dhe na e ka mundësuar zyrtari i teknologjisë informative, të cilin e falënderoj sepse kemi qasje në dokumente zyrtare, pra i kemi nxjerrur faturat se kujt i'u janë kryer pagesat dhe për çfarë janë bërë ato.

z. Kumrie Hoti, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dha disa sqarime, mirëpo mua personalisht si këshilltare e Kuvendit nuk mu përgjigj në pyetjet që i bëra më parë. Si projekt prioritar për vitin 2013 për fshatin Revuç ishte paraparë dhe ishte i miratuar në Kuvend një investim prej 50,000.oo €, ndërkaq nuk është realizuar, ajo rrugë nuk ka qenë në listën e projekteve të cilat presin donatorë, andaj unë pres përgjigje nga drejtori sepse e ka për obligim të na jap.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se për këtë çështje deri më tani u debatua mjaft dhe u dhanë sqarime të mjaftueshme, materialin e keni në dispozicion të gjithë, po ashtu këtë material do të ketë në posedim edhe auditori i cili nëse konstaton parregullsi apo dyshim mund të bëjë vërejtje apo të rekmandoj dhe verifikoj atë, mirëpo ashtu siç e potencoj edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, ndonjëherë mund të rrjedh ndonjë gabim qoftë teknik apo në përshkrim ngase është material i gjerë ky raport.

z. Kadri Avdiu, theksoi, zotëri Kryesues pas qdo sqarimi të drejtorëve ne këshilltarët e Kuvendit kemi të drejtë të marrim fjalën, andaj mos u mundo ta mohosh këtë dhe mos u mundo të ngulfatësh Kuvendin.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e sqaroi por nuk e arsyetoj ashtu siç duhet, ngase nga mbledhje e Komitetetit për Politikë dhe Financave e cila është mbajtur dy ditë më parë ka mundur të përgatitë me shkrim një sqarim apo arsyetim dhe të na dorëzoj neve si këshilltarë, për të gjitha ato vërejtje të cilat janë bërë dhe që u bënë edhe sot, gjithashtu drejtori nuk u përgjigj rreth çështjes që u ngrit për punëtorët me kontratë mbi vepër të cilët ekzistojnë që nga viti 1999 dhe ka disa për 2 vite, për 12 muaj, e tjera, mirëpo në ato çështje në të cilat nuk mund të përgjigjet i lë në mjegull, pra drejtorët e Drejtorive duhet t'i përgjigjen vërejtjeve dhe pyetjeve të këshilltarëve në qoftë se kanë argumente në qoftë se nuk kanë atëherë le të dalin në foltore dhe le të potencojnë se nuk janë lëshime të tyre por janë urdhra të ndokujt dhe se ata drejtor duhet vetëm t'i respektojnë ato urdhra, andaj mos ta marrin përgjegjësinë e të tjerëve, siç është rasti i drejtorit të drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë në atë vit kam qenë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, Drejtori për të cilën u shtruan disa pyetje do të mundohem t'i jap disa sqarime në pikë të shkurta, projektet të cilat kanë qenë të miratuar në Kuvendin e Komunës për vitin 2013 si dhe ato në rishikim të buxhetit, të gjitha janë realizuar por ka pasur edhe projekte tjera të cilat janë kryer dhe që nuk kanë qenë të miratuar. Sa i përket atyre mjeteve të cilat kanë qenë të ndara për fshatin Revuç, janë bartur një vit përpëra në një projekt që ka qenë rreth 120,000.oo € për atë fshat, pra nuk kanë mjaftuar mjetet përkatëse dhe është dashur të barten nga viti i kaluar, prandaj të mos merremi me disa gjëra sepse jeni në dijeni të gjithë, se 90% e fshatrave të Komunës së Podujevës janë kryer projektet e parapara, ndërsa për fshatin Revuç këtë vit janë paraparë 90,000.oo €.

Gjithashtu vlen të ceket se këtë vit ka ndryshuar Ligji i Prokurimit në bazë të të cilët nuk mund të investohet askund më, nëse nuk ka projekt zbatues nga ai Komunitet.

z. Kumrie Hoti, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është kërkuar që të miratohet projekt i cekur për fshatin Revuç me kusht që ata banorë të atij fshati të përgatitin projektin, andaj unë pyes përsë ekziston Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe zyrtarët të cilët punojnë aty të cilët janë të obliguar të bëjnë projekte, dhe

pse ndërmarrin iniciativë qytetarët vetë kur kjo është obligim i Komunës por ne kemi parasysh dhe faktin që projekti për asfaltimin e asaj rruge është miratuar në këtë Kuvend.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në bazë të ligjeve në fuqi, inxhinierët e Komunës deri tani kanë pasur të drejtë t'i bëjnë paramasat dhe parallogaritë, që do të thotë pa projekt, sepse projektet i bëjnë vetëm kompanitë e specializuara ngase Komuna nuk ka të drejtë të bëjë projekte, ndërsa nga ky vit që jemi inxhinierët e Komunës nuk kanë të drejtë të bëjnë më as paramasa e as parallogari, por këto të drejta i kanë vetëm kompanitë e licencuara për hartimin e projekteve, pra pa i kryer komunitetet këto procedura nuk mund të ketë zhvillim të projekteve, kështu që ne jemi këtu përgjegjës për zbatim të ligjit dhe përgjegjës për çdo cent të shpenzuar, andaj me këto plotësimë e hedhë në votim propozim raportin financiar për vitin 2013.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 16 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur miratohet rapporti financiar për vitin 2013

4. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2013 në vitin 2014 dhe destinimi në kategori të caktuara buxhetore

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, meqë kjo bartje bazohet kryesisht në të hyrat vetanake të realizuara dhe të paspenzuara për vitin 2013 e që ligji për buxhetin e parasheh një gjë të tillë që mjetet përkatëse të barten nga viti paraprak në vitin aktual, dhe gjithashtu duke u bazuar në sqarimet që i bëri drejtori parafolës ky propozim është përfshirur nga të gjithë, në mënyrë që mos të vonohemi që këto mjete të janë në disponim përfshirë sipas propozim vendimit dhe specifikacionit i cili në mënyrë të qartë tregon se ku duhet të barten mjetet përkatëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, parafolësi e tha se duhet të ngutemi që t'i alokojmë sa ma shpejtë këto mjete, dhe pajtohem me atë që e tha drejtori në fjalën hyrëse se mjetet nga Shëndetësia dhe Arsimi nuk mund të barten në dikastere tjera sepse janë të hyra nga ato shërbime. Sa i përket shumës 132,000.oo € për Administratë dhe për projektet paraprake të vitit 2013 nuk do të ndalem sepse nuk kam qenë pjesë e këtij Kuvendi mirëpo për të qenë shumë transparent i nderuar këshilltar i Kuvendit (i drejtohet parafolësit), drejtori shumë mirë e ka përgatitur dhe e ka renditur dokumentacionin, dhe jemi në dijeni se shpenzimet nuk i ka bërë dikasteri i financave por ky dikaster vetëm i ka ndarë ato, ndërsa shpenzimet i kanë bërë Drejtoritë tjera, por ka qenë mirë që Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të na i dëshmon projektet neve si këshilltarë të rijnë ngase pak më parë u tha këtu se janë kryer të gjitha projektet e miratuarë në Kuvend por edhe projekte tjera të cilat nuk kanë qenë të planifikuarë, ndërsa Drejtoria e cekur të cilën e ka drejtuar Kryesuesi aktual i Kuvendit është dashur që vetëm t'i zbatoj, prandaj e thash që është dashur që ne si këshilltarë të rijnë të Kuvendit t'i kemi në dispozicion ato projekte në mënyrë që të mos paraqitet kurrrafë pengese për miratim të kësaj shume prej 132,000.oo €.

Çështja tjetër ka të bëjë me shpenzimet në Shëndetësi dhe Arsim, është e qartë se te shpenzimet në Shëndetësi prej 38,714.oo €, pa dashur të ndalem te numrin Qendrave të mjekësisë familjare dhe numrin e punonjësve të cilët bëjnë kujdestari në pjesët urbane

dhe në ato rurale, mirëpo dua të aludoj në atë se nëse Drejtoria përkatëse e posedon legjislacionin pér punëtorët do të shëh se ata punëtorë marrin pagat e tyre ndërsa Komuna nuk mund të rritë pagën nëse i merr 38,714.oo € sepse, nëse një shërbyes civil apo një infermiere e ka pagën 600.oo € do t'ju bëhet paga 1,000.oo € dhe se jemi në dijeni se sa është koeficienti i kujdestarisë.

Çështje tjetër që dua ta ngriti në formë të pyetjes pér drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale se a mund të marr fjalën dhe të na tregoj se sa punëtorë ka të punësuar në Drejtorinë përkatëse me kontratë mbi vepër, e cila është shkelje e ligjit, gjë pér të cilën mendoj se ne jemi të detyruar të dërgojmë këtë rast në hetuesi dhe gjykata të vendos, ngase pér këtë, ne jemi në dijeni se Ligji i Shërbimit Civil nuk e lejon që një punëdhënës të mban punëtorin me kontratë mbi vepër 12 muaj dhe pér këtë ne jemi në dijeni se kemi raste se disa prej atyre punëtorëve nuk vijojnë në punë fare. Prandaj pér këto dhe arsyet tjera ne nuk mund që ta miratojmë këtë propozim vendim, gjithashtu vlen të ceket se ne nuk jemi pér të tjetërsuar shumën e bartjes së mjeteve pér Shëndetësi por jemi, dhe është interes i qytetarëve, që këto mjete të shkojnë pér pajisje dhe ngritje të standardeve në qendrat e mjekësisë dhe të shërbimeve mjekësore, se sa të barten pér pagesën e punëtorëve të paparaparë nëpër qendra shëndetësore, pra ato mjete nuk mund të barten pér paga por vetëm pér çështje shëndetësore sepse Ligji i Shërbimit Civil nuk e lejon këtë dhe nëse ndokush nga Ekzekutivi ka tjetër mendim lirshëm mund të marr fjalën dhe të thotë, dhe ju garantoj se secili këshilltarë që do të merr hapë pér këtë çështje, si pér Shëndetësi si në Arsim, do të hapet rast penal sepse kemi fakte me emra.

Ne nuk jemi as kundër raportit finansiar i cili posa u miratua, mirëpo në këtë raport mendoj dhe ka opsione pér raste penale sepse sa unë jam dijeni në donacionin e Ligenit të Batllavës ku janë shpenzuar rrëth 2,000,000.oo € është vepër penale, ngase është degradim, dhe se jam i mendimit se ky Kuvend nuk ka qen i aftë të menaxhoj ujësjellësin Batllava. Pra kam pyetje pér Kryesuesin e Kuvendit, a mundësh me na tregu pér ato projekte pér të cilat u diskutua më herët, se a kanë qenë prioritete pér vitin 2013 dhe a kanë qenë të miratuara në Kuvend.

z. Haki Rudari, theksoi, këtu tani u ngritën disa çështje mjaft të ndjeshme pér të cilat mendoj se është e nevojshme të diskutohen më detajisht sepse nëse ka me të vërtetë persona të cilët vetëm marrin pagë dhe nuk punojnë fare dhe nëse ka persona të cilët marrin pagë me kontratë mbi vepër është shumë mirë të prezantohet më detajisht kjo çështje. Shqetësimi tjetër të cilin e ngrisim ne, ka të bëjë me Shëndetësinë dhe Arsimin ku është dashur të kemi edhe më shumë investime sepse në shumë shkolla kemi mungesë të ujtit të pajes që ndoshta me këto mjete do të mund të rregulloheshin 3 – 4 shkolla ose edhe më shumë, ndërsa në Administratë 132,222.oo € është një shumë pér të cilën mendoj se pikërisht mungesa e planit të punës së Drejtorive e bënë këtë çështje dilemë ngase sikur ne të kishim këtë plan program do të kishim më të lehtë të votojmë, por shpresoj që në të ardhmen do të kemi atë plan të Drejtorive komunale.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, drejtorët e Drejtorive shpesh herë neve këshilltarëve të Kuvendit na qesin në situata të pakëndshme, sepse fundja është obligim ligjor i tyre që të hartojnë planin e punës prej 31 marsi të këtij viti kalendarik gjë e cila nuk është bërë kështu që ne vijmë në telashe kur të vie koha të vendosemi pér çështje të ndryshme, nuk është normale mos me votu bartjen e këtyre mjeteve sepse duhet të vazhdohet tutje me zhvillim të këtij vendi, prandaj sinqerisht i kisha lutur drejtorët e Drejtorive që t'i kryejnë

detyrat e tyre sipas ligjeve dhe sipas afateve sepse ka kaluar koha e ujrave të qeta kur kemi votu gjëra të ngjashme, e them këtë ngase ndokush mund të shkoj në përgjegjësi penale, prandaj mos na bini në situata të tilla por të jeni të kujdeshëm me dokumente në mënyrë që ne ta kemi më të lehtë votimin.

Në fakt do të votoj për këtë bartje të mjeteve sepse Komuna jonë ka nevojë për zhvillim ekonomik, mirëpo prapë qëndroj në lutjen që të jeni më të kujdeshëm dhe të prezantoni planin e punës si të Kryetarit të Komunës ashtu edhe të dikastereve tjera.

z. Kadri Avdiu, theksoi, vërejtjet konsistonjë në atë sepse çdo fillim vit apo fund vit kemi bërë bartje të mjeteve dhe gjithmonë na është thënë se në qoftëse nuk barten ato mjete do të humbin, gjë për të cilën nuk kem dëshirë as ne që të humbim mjete rreth 200,000.00 €, por çështje të cilën dua të theksoj është se nuk kemi plan të punës të Ekzekutivit të Komunës, vërejtje të cilën e përmenden edhe parafolësit e për të cilën mendoj se Ekzekutivit i konvenon kjo mjegull, konsideroj se me këtë dëmtohet qytetari ndërsa ne vihemë para një akti të kryer, sepse na thuhet se nëse nuk votojmë dhe nuk alokohen këto mjete do të humbin ndërsa ne duhet patjetër të mbështesim por që, në anën tjetër me to mjete bëhet lojë nga Ekzekutivi.

z. Nexhmi Rudari, theksoi, mora fjalën me të vetmin qëllim që të mundohem të bëjë një sqarim sa i përket planit të shpenzimeve për Arsim gjë të cilën në vija të trasha e sqaroj drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, se ku dhe si barten ato mjete. Mjetet përkatëse janë të hyra nga pagesat që bëjnë prindërit të cilët i vendosin fëmijët e tyre në çerdhe, dhe nga të hyrat që inkasohen nga pagesat e atyre që kryejnë arsimin e mesëm të lartë apo siq quhet ndryshe arsimin joformal. Nga pagesat që bëhen në dy shkollat profesionale, në atë teknike dhe në atë ekonomike, është shumë e qartë dhe e precizuar me Udhëzim Administrativ ku thuhet se 70% e atyre mjeteve shfrytëzohen ekskluzivisht për pagesën e mësimdhënësve të cilët e mbajnë atë mësim joformal dhe nuk mund të tjetësohen ato mjete, ndërsa 30% e tyre mjeteve u kthehen shkollave përkatëse përmallra dhe shërbime. Përndryshe pagesat e fundit që janë bërë në semestrin e fundit, nuk kemi mundur t'i përgatitim për ti dërguar për pagesa sepse këto mjete do të ishin shpenzuar në muajin dhjetorë të vitit të kaluar, por që atëherë afati i pagesave ka qenë i limituar.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë u kërkua të sqarohet për mjetet të cilat do të barten në Administratë do të mundohem të jap unë një sqarim, është menduar që ato mjete të barten në Administratë, sepse të hyrat të cilat inkasohen në muajin nëntor dhe dhjetorë sipas ligjit nuk mund të përdoren në atë vit por vetëm duhet të barten në vitin vijues, dhe këto mjete destinohen për projekte të papërfunduara të vitit 2013.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim

Pas disa kërkeseve të disa këshilltarëve të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit vendosi që deri në ora 13:00, përkatësisht 1 orë të ketë pauzë.

Pas pauzës njëorëshe, mbledhja rifillon në orën 13:00, fillimisht u konstatua se ekziston kuorumi përkatësisht janë të pranishëm shumica e këshilltarëve të Kuvendit.

5. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Fexhari Sylës – Gllamnik, Smajl Isufit – Majac, Fadil Zhitit – Lluga, Abit Bunjakut – Sallabajë, Adem Kamerollit – Llapashticë e Poshtëme, Faik Zhitia – Lluga)

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur dy ditë më parë, pas diskutimeve për këto propozim vendime i kemi rekomanduar Kuvendit që këto propozime të kompletohen për këtë mbledhje me kopje të planit dhe të shkohet me votim veç e veç për secilin propozim vendim, mirëpo nëse dëshironi ne mund t'i bashkojmë të gjitha këto propozim vendime dhe të votojmë për të gjitha për njëherë.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, sa kam vërejtur, në këto propozime ka edhe prona private për të cilat kërkohet ridestinimi i tokës, por e vetmja gjë e cila më intereson, dhe që nuk kam njojuri të mjaftueshme, dhe për të cilën i pyes personat kompetentës sështë, se a ka apo nuk konflikt ligjor në këto çështje. Andaj nëse janë në harmoni me ligjin mendoj se duhet të votohet për të gjitha sepse sështë e drejtë ligjore që ata persona të cilët kanë bërë kërkesat e tyre të shfrytëzojnë pronat e tyre. Pra vetëm këtë sqarim desha të kërkoj të na jap ndokush këtu se a kemi ndonjë pengesë ligjore.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kërkesat e palëve janë shqyrta nga Drejtoria përkatëse dhe në bazë të ligjit dhe Udhëzimit Administrativ përkatës për destinim të tokës sështë Kuvendi, nga këto kërkesa dy prej tyre të cilat kanë klasin deri në të katërtën, pas vendimit të Kuvendit dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe nëse ajo Ministri e jap pëlgimin atëherë mund të procedohet më tutje, nëse jo atëherë ajo tokë mbetet e pashfrytëzuar.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në Komitetin për Politikë dhe Financa ka qenë qëndrim i të gjithë anëtarëve që këto propozime të shqyrtohen veç e veç. Kam një propozim që propozimet – kërkesat e z. Faik Zhitit dhe z. Fadil Zhitit, të mos miratohen sepse ne me propozim të Kryesuesit të Kuvendit e kemi caktuar një mbledhje të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa me vetëm një pikë të rendit të ditës për Obeliskun e Heroit Afrim Zhitia ku përfshihen edhe dy peticionet e bëra për atë pjesë në të cilët janë të përfshirë edhe personat e lartë cekur, andaj edhe kërkova që mos të miratohen kërkesat e tyre përderisa të zgjidhet çështja e Obeliskut. Prandaj konsideroj se sështë mirë që këto propozime të shqyrtohen veç e veç në mënyrë që pastaj të mos na paraqitet ndonjë problem i mundshëm neve si Kuvend që do të na vështirëson punët shumë në terren.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe pse këto dy prona të personave që i përmendi parafolësi janë prona private të tyre konsideroj se nuk ka asgjë të keqe që të lihen dhe të shqyrtohen në një mbledhje të ardhshme të Kuvendit, por edhe nëse sot do të miratoheshin nuk do të paraqitnin ndonjë problem.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, sa i përket kërkesave të qytetarëve të cilët i kanë bërë për shëndrrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ka disa ditë që u janë drejtuar Drejtorisë që unë e udhëheqë, kështu që unë kërkoj që këto propozim vendime të hedhen në votim dhe të votohen qoftë veç e veç qoftë në tërësi sepse kemi një afat për t'i dërguar në Ministrinë përkatëse dhe ky afat nuk sështë mirë të kaloj, e them këtë ngase unë në cilësinë e drejtorit jam i obliguar t'ju kthejë një përgjigje, qoftë pozitive qoftë negative parashtruesve të kërkesave.

z. Kadri Avdiu, theksoi, pajtohem me atë që e potencoi z. Rafet Llapashtica lidhur me këtë çështje, gjithashtu kërkoj që të kemi kujdes në mënyrë që të mos merret kjo gjë në aspektin politikë dhe t'ju thuhet në të ardhmen atyre qytetarëve se kemi dal para aktit të kryer. Lidhur me atë që e tha drejtori unë mendoj se nuk do të paraqiste ndonjë problem në qoftëse këto dy propozime - kërkesa të shtysheshin për ndonjë mbledhje të radhës, sepse nuk kanë të bëjnë me ndërtim të stallave apo gjëra të ngashme të cilat kërkojnë afate të përcaktuara, ndërsa ato dy prona për të cilat u kërkua të shtyhen, janë ngjit me pronat komunale, prandaj kërkoj që të lihen për ndonjë mbledhje tjetër.

z. Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë që në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ka qenë qëndrim i jonë që këto propozime – kërkesa të shqyrtohen dhe të hedhen në votim veç e veç. Meqë dy persona të cilët kanë parashtruar kërkesa për shëndrrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore janë në mesin e të nënshkruarve në peticione, unë plotësisht pajtohem që ato dy propozime – kërkesa të lihen për mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa në mënyrë që të analizohen në detaje, ndërsa tjerat propozimet tjera të votohen sot.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, kërkoj që këto propozim vendime të hedhën në votim si pako.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit shumë mirë e sqaroi se duhet respektuar afatet ligjore të shqyrimit të këtyre kërkesave, unë nuk jam në dijeni se kur janë parashtruar ato kërkesa, mirëpo konsideroj se është shumë e pamoralshme, joetike dhe jo e drejtë që ju si Kryesues i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe z. Fidan Rekaliu si anëtarë i këtij Komiteti jeni në dijeni se është vendosur në Komitetet për Politikë dhe Financa që këto propozime – kërkesa në Kuvend të plotësohen me fletë poseduese dhe të shqyrtohen veç e veç.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jam në dijeni se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, pas diskutimeve që kemi bërë kemi marr qëndrim dhe i kemi rekomanduar Kuvendit që këto propozim vendime të shqyrtohen dhe të votohet për secilën veç e veç, mirëpo ne këtu patën propozim që të hedhën në votim të gjitha për njëherë. Atëherë për të mos zgjatur më shumë rreth kësaj çështjeje i hedhë në votim një nga një:

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi sipas kërkesës së Fexhri Sylës nga fshati Gllamnik.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi sipas kërkesës së Smajl Isufit nga fshati Majac.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 15 vota kundër dhe asnjë votë të përbajtur u miratua propozim vendimi sipas kërkesës së Fadil Zhitit nga fshati Llugë

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi sipas kërkesës së Abit Bunjakut nga fshati Sallabajë.

Para se të votohet për propozim vendimin sipas kërkesës së Adem Kamerolli, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se z. Mirsad Kamerolli, këshilltar i Kuvendit, për shkak të konfliktit të interesit, përkohësisht është larguar nga salsa e mbledhjes.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 1 votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim vendimi sipas kërkesës së Adem Kamerollit nga fshati Llapashicë e Poshtme.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 14 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim vendimi sipas kërkesës së Faik Zhiut nga fshati Llugë

6. Propozimi i Vendimit për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim ju njoftoj se është duke u përgatitur për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit një Rregullore e cila do të përcaktoj mënyrën dhe kriteret e ndarjes së shtëpive të ndërtuara në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

Gjithashtu ju njoftoj se Komuna e Podujevës ka nënshkruar një memorandum me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, memorandum i cili e obligon Komunën e Podujevës të formon një komision prej 5 anëtarëve me këtë përbërje, 3 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 1 anëtar nga Shoqatat e dalura nga lufta dhe një anëtar nga shërbimi civil i Komunës. Në Komitetin për Politikë dhe Financa i kemi propozuar emrat dhe i kemi rekomanduar Kuvendit përbërjen e komisionit përkatës me këta emra: nga subjekti LDK z. Avni Ajeti, nga subjekti PDK z. Kadri Avdiu, nga LVV z. Haki Rudari, nga shërbimi civilë i Komunës është z. Ruzhdi Dema, dhe një përfaqësues nga Shoqatat e dalura nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilave do ju bëjmë thirrje ta dërgojnë emrin e përfaqësuesit të tyre, si dhe në cilësinë e vëzhguesit do të jetë edhe një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, andaj e hedhë në votim.

Pas votimit u konstatua se me 30 vota për, 2 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur u miratua ky propozim vendim për ngritjen e komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, në këtë përbërje:

- z. Avni Ajeti, kryesues, nga radhët e LDK-së
- z. Kadri Avdiu, anëtar, nga radhët e PDK-së
- z. Haki Rudari, anëtar, nga radhët e LVV=së
- z. Ruzhdi Dema, anëtarë, shërbimi civil i Komunës,
- _____, anëtar, Shoqatat e dalura nga lufta, dhe
- _____, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

7. Themelimi i Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane të qytetit, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, këtë pikë të rendit të ditës e kemi propozuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim. Përbërja e këtij komisioni është propozuar të jetë kështu; 5 anëtarë nga subjekti LDK, 4 anëtarë nga PDK, 1 anëtarë nga LVV dhe 1 anëtarë nga AAK, gjithashtu vlen të

theksohet se nuk jemi fokusuar vetëm në anëtarët e Kuvendit, por jemi marr vesh që secili subjekt i përfaqësuar në Kuvend mund të propozoj edhe emra të tjerë të fushave të ndryshme si, historian, gjeograf, gjuhëtarë etj. të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit. Andaj këtë strukturë ne mund të hedhim në votim, kurse emrat e anëtarëve mund t'i sjellin secili subjekt në Zyrën Ligjore më së largu deri më 16.04.2014, sepse duhet që në vendim, i cili më së largu më 17.04.2014 duhet të dërgohet për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrin përkatëse, të përfshihen edhe emrat.

z. Naim Çunaku, theksoi, ka qenë nevojë e kahershme që të emërtohen rrugët, sheshet, lagjet, rrugicat, mirëpo ashtu siç e tha në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa Nënkyetari i Komunës, është një projekt i cili financohet nga Komisioni Europian gjegjësisht nga Shteti Norvegjez, që në formë të ortofotove çdo rrugë, lagje, shesh, rrugicë, në territorin e Komunës së Podujevës të emërtohen, prandaj duke u paraqitur kjo nevojë duhet të themelohet komisioni përkatës i cili deri më 1 korrik 2014 duhet të përfundoj punën, dhe si nevojë e ngutshme është paraparë që ky komision të merr propozimet e emërtimeve nga debatet publike me qytetarë dhe t'ia propozoj Kuvendit për miratim. Në këtë përbërje është paraparë të jetë formula e KPF-së me përashtim që në këtë komision të përfshihet edhe një përfaqësues nga radhët e AAK-së mirëpo duke u munduar që t'i kontribuojmë sa më mirë dhe sa më shumë kësaj çështjeje do të ishte mirë që nga këta anëtarë të këtij komisioni të kemi së paku gjysmën nga Kuvendi apo secili subjekt të ketë minimum një anëtarë nga Kuvendi. Ne subjekti PDK, sot nuk jemi të gatshëm ti japim emrat e propozuar për anëtarë të këtij komisioni, mirëpo do ti sjellim shumë shpejt në mënyrë që ashtu siç e tha Kryesuesi të përfshihen në vendim.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, konsideroj se për këtë çështje disa Komuna janë vonuar, por sido që të jetë, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e AAK-së dega në Podujevë, propozojmë që në këtë komision të jetë z. Lutfi Rexhepi.

z. Durim Salihu, drejtori Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, dëshiroj t'ju njoftoj se me ftesë të zëvendësministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal unë së bashku me Nënkyetarin e Komunës kemi qenë në një takim në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Komisionit Europian dhe drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, takim ku neve si Komunë na janë dhënë këto detyra.

Lidhur me formimin e komisionit nuk mendoj se do të paraqitet ndonjë problem sepse janë kriteret në Udhëzuesin përkatës të cilin mund të shkarkohet në faqen zyrtare të Agjencionit Kadastral të Kosovës, kritere të cilat e lehtësojnë shumë punën. Meqë kjo çështje ka të bëjë me emërtimin e të gjitha rrugëve, rrugica, shesheve, lagjeve në tërë territorin e Komunës së Podujevës do të ishte mirë që të gjitha subjektet të cilat bëjnë pjesë në përbërjen e këtij komisioni t'i angazhojnë ekspertët e tyre të fushave të ndryshme në kuadër të komisionit në mënyrë që të merren propozime të emërtimeve sa më adekuate.

z. Naim Çunaku, theksoi, në diskutimin e mëparshëm, unë u mundova të jap disa sqarime vetëm në vija të trasha, por nuk jam në dijeni se a është menduar kostoja financiare e këtij komisioni sepse me siguri se do të ketë shumë punë si në terren ashtu edhe në takime të komisionit të cilat mendoj se do të jenë të shpeshta. Pra kur e thash këtë desha të pyes se kush duhet të merr vendim për kompensimin e komisionit përkatës.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhë e subjektit të Lëvizjes Vetëvendosje, përkrahim fuqimisht formimin e këtij komisioni dhe për anëtar propozojmë z. Bahri Selimin.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra konsideroj se LDK dhe PDK mbetet t'i propozojnë anëtarët e tyre dhe t'i dërgojnë më së largu deri më 16.04.2014 ndërsa për çështjen e kompensimit të këtij komisioni do të shqyrtojmë në të ardhmen se si mund të gjejmë ndonjë formë përmarrjen e vendimit përkompensim.

z. Kadri Avdiu, theksoi, çështjen të cilën e shtroi z. Naim Çunaku përkompenzimin e anëtarëve të komisionit përkatës, konsideroj se është plotësisht e drejtë sepse në mandatin e kaluar ka qenë i ngritur ky komision dhe asnjëherë nuk mbledhur, ndërsa ne tani për këtë afat kaq të shkurtë duhet të mbledhemi disa herë si dhe të organizojmë takime me qytetarë në lokalitete të ndryshme. Prandaj kërkoj që të kompensohet ky komision, dhe mos të mbetet sikurse që ka mbetur komisioni i mandatit të kaluar në krye me Nënkyetarin e Komunës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se këtij propozim vendimi është mirë t'i shtohet një konkluzion me të cilin përcaktohet që në bazë të një vendimi të mëvonshëm të rregullohet çështja e kompensimit të anëtarëve të komisionit.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim duke u përfshirë edhe konkluzioni përkompensim të anëtarëve të komisionit, në këtë strukturë,

1. Mehmet Gashi, kryesues, nga radhët e LDK-së
2. Adem Ajvazi, anëtar, nga radhët e LDK-së
3. Avni Maloku, anëtar, nga radhët e LDK-së
4. Fatlume Jaha, anëtare, nga radhët e LDK-së
5. Musli Muçiqi, anëtar, nga radhët e LDK-së
6. Kadri Avdiu, anëtar, nga radhët e PDK-së
7. Naim Çunaku, anëtar, nga radhët e PDK-së
8. Hilmi Hoxha, anëtar, nga radhët e PDK-së
9. Hakif Mehmeti, anëtar, nga radhët e PDK-së
10. Bahri Selimi, anëtar, nga radhët e LVV-së, dhe
11. Lutfi Rexhepi, anëtar nga radhët e AAK-së

(emrat e cekur, nga subjekti LDK dhe subjekti PDK, janë dërguar pas përfundimit të mbledhjes dhe të njëjtit i kemi përfshirë në këtë Ekstrakt të procesverbalit)

8. Të ndryshme

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, të nderua kolege dhe kolegë, unë nuk kamë qenë në dijeni se kjo pikë e rendit të ditës, për emërtimin e adresave në territorin e Komunës së Podujevës, do të jetë sot, prandaj të gjithë juve dhe Kryesuesit të Kuvendit me qëllim që t'ia përcjell Kyetarit të Komunës, ju kam dërguar një propozim në të cilin kam kërkuar të më mbështetni. Propozimi ka të bëjë me emërtimin e ndonjë hapësire publike (shkollë, rrugë, shesh,) me emrin Ramush Rama, dhe tani dëshiroj të paraqes arsyetimin e këtij propozimi,

Ramush (Rahim) Rama, i lindur më 25.03.1934 në fshatin Barainë të Komunës së Podujevës, shkollën filllore katër klasëshe e kreu në fshati Orllan, kurse para Gjimnazit

në Podujevë në vitin 1950, shkallën e parë të Fakultetit Filozofik e kreu në Prishtinë në vitin 1964 – dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakultetin Filozofik e mbaroj në Beograd në vitin 1972 – dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Veprimtaria:

- Podujevë, mësues klase në vitin shkollor 1952 – 1953
- Referent i Arsimit në rrithin e Llapit – Podujevë 1953 – 1955
- Inspektor i Arsimit në rrithin e Prishtinës 1955 – 1958
- Drejtor i Konviktit të Shkollës Normale në Prishtinë 1959 – 1961
- Kryeshef i Arsimit dhe Shëndetësisë në Komunën e Podujevës 1961 – 1965
- Gazetar në Zyrën e Informimit të Kuvendit të Kosovës 1965 – 1967
- Kryetar i Kuvendit të Komunës së Podujevës 1967 – 1969
- Kryetar i Këshillit për Arsim, Shkencë e Kulturë në Kuvendin e KSAK 1969 – 1974
- Drejtor i Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të KSAK 1974 – 1981
- Redaktorë i Teksteve për Shkolla të Mesme në Entit e Teksteve 1981 – 1991

Në moshën 57 vjeçare pensionohet, pas uzurpimit të Entit nga ana e pushtetit serb dhe venia e masave të dhunshme nga ana e Beogradit. Vdiq në Prishtinë më 27.02.2000.

Kontributi i tij njihet në përhapjen e Arsimit përkatësisht zgjerimin e rrjetit të shkollave tetëvjeçare në Komunën e Podujevës. Derisa ushtronte funksionin e Kryeshefit të Arsimit dhe Shëndetësisë nga viti 1961 e deri më 1965 përfshirja e nxënësve në shkollim të rregullt, në atë kohë, arrin mbi 80% të gjeneratës. Me angazhimin e tij dhe nën përkujdesjen direkte të tij, u hapë në Podujevë më 01.09.1961 për herë të parë Gjimnazi “8 Nëntori”, në fillim si paralele e ndarë e Gjimnazit të Prishtinës, e një vit më vonë si i pavarur.

Me kërkësën gjithëpopullore të trevës së Llapit, Ramush Rama zgjedhet Kryetar i Kuvendit Komunal të Podujevës më 22 maj 1967, të cilën detyrë e ushtroi deri në nëntor të vitit 1969 kur zgjedhët Kryetar i Këshillit për Arsim Shkencë dhe Kulturë të Dhomës Krahinore të Kuvendit të KSAK-së. Gjatë këtij mandati ishte shumë aktiv në formimin e institucioneve arsimore e shkencore me rëndësi për Krahinën, si Fakultetin e Mjekësisë, RTV e Prishtinës, Universitetin e Prishtinës dhe shumë fakultete e shkolla tjera të larta. Rruga jetësore e Ramush Ramës është përplot me sfida, rreziqe dhe kontradikta shoqërore. Në gjithë veprimtarinë e tij ai njihet si njeri me vlera të larta humanitare, patriotike dhe intelektuale dhe me vizion largpamës. Patriotizmi, vendosmëria dhe guximi intelektual të mëshiruar në karakterin e tij, pothuajse në të gjitha fazat e zhvillimit dhe emancipimit të qenies dhe vetëdijes kombëtare e bëjnë atë personalitet të veçantë nga të tjerët, duke pasur parasysh se veprimi me vendosmëri dhe guxim në situata të ndërlikuara politikisht dhe të pakëndshme, rrezikon jo vetëm jetën e Ramush Ramës por edhe atyre që e shoqëronin në realizimin e synimeve të tij gjithëkombëtarë. Veprimet e tij në situata që konsideroheshin si të pavolitshme që përbën kalim radikal të shtetit administrativ dhe të byroktarizuar, në një formë shtetërore më pak të etatizuar dhe e diskriminuar, sa i përket qeverisjes, ishin aq të furishme, nganjëherë edhe rebeluese sa që elitat partiale të të dy niveleve nuk merrnin guximin t'i dilnin përball Ramush Ramës.

Andaj padashim se emërtimi i ndonjë hapësire publike (shkollë, rrugë, shesh) me emrin e atdhetarit Ramush Rama, është veprim dhe kontribut për personalitetin e tij i cili

i ka shërbyer me përkushtim të lartë profesional dhe kombëtarë duke pasur gjithmonë synim parësor avancimin e Kombit dhe vlerave të shoqërisë sonë. Mbi të gjitha është nderë që Komuna e Podujevës të vendosë në hapësira publike emrin e patriotit Ramush Rama, në mesin e shumë emrave të shquar të trevës sonë.

z. Adelinë Stublla, theksoi, bazuar në raportin statistikorë të Agjencisë Statistikore të Kosovës, në qytetin tonë gjatë vitit 2012 ka pasur 1540 lindje. Lidhur me këtë unë dua të propozoj modelin e Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit z. Refki Suma, i cili vendosi t'i shpërblej të gjitha nënët banuese të territorit të asaj Komune të cilat lindin fëmijë, ku si vendim mendoj se është shumë i qëlluar. Për këtë kisha dashur që edhe në Komunën tonë, të gjitha ato nëna të cilat lindin fëmijë të shpërblehen me një shumë të përballueshme nga buxheti i Komunës tonë, nuk dua të hyjë në detaje se cila kategori e shpenzimeve është më e rëndësishmja e cila më urgjente, këtë më mirë e vlerëson Komitete për Politikë dhe Financa. Dëshiroj t'ju kujtoj se nataliteti në vendin tonë ka rënë dukshëm ku si faktorë ndikues është faktori ekonomik e që ne të gjithë jemi në dijeni se sa shpenzime kemi për të rritur një fëmijë të porsalindur. Prandaj konsideroj se ky gjest të cilin e propozova do të ishte një përkrahje jo vetëm financiare por edhe morale për ato nëna të cilat lindin fëmijë. Andaj ju lutemi që këtë propozim ta miratoni.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45'

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-50512
Podujevë,
10 prill 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**